



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 80- Shkurt- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - www.malisheva-komuna.org



Pamje nga vendosja e buqatave me lule te shtatorja e Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, me rastin e Dy Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së shtetit të Kosovës



Përmbajtja

Kryetari Kilaj kërkon zbatimin e vendimeve.....	3
Kryetari Kilaj priti drejtorin regional të OSBE-së	3
Premtohet mbështetje për shoqatën e të verbërve në Malishevë.....	2
Kërkohet harmonizimi i rregulloreve komunale me ligjet në fuqi.....	4
Brenda javës konkursi edhe për mësimdhënës për Qendrën e Kompetencës	5
Kilaj: “Jemi krenar për luftën që bëmë për shtetin tonë, Republikën e Kosovës”	6
Së shpejti do të formohet Komiteti për Biznese	8
Mbahet mbledhja e parë e KPF-së.....	9
Formohet komiteti i biznesit në Malishevë	9

Nga mbledhja e qeverisë komunale

Kryetari Kilaj kërkon zbatimin e vendimeve

Malishevë, 1 shkurt

Në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka kërkuar nga drejtorët zbatimin e të gjitha vendimeve që merren, duke përdorur të gjitha format e lejueshme, që merren nga ana e organeve vendimmarrëse në komunë.

Po ashtu, në këtë mbledhje, u bë e ditur se pas fillimit të punës së drejtorive nga java e kaluar, edhe përkundër rritjes së numrit, të gjitha drejtoritë janë sistemuar në zyrat e veta dhe puna po vazhdon normalisht.



Në këtë takim të rregullt të qeverisë komunale, drejtorët kanë raportuar për punët dhe obligimet, që kanë pasur gjatë javës, ndërsa u diskutua edhe për përgatitjet nga ana e drejtorisë për kulturë, për shënimin e 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së shtetit të Kosovës.

Kryetari Kilaj priti drejtorin regjional të OSBE-së

Malishevë, 2 shkurt

Sot, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur në një takim, drejtorin e Qendrës Regjionale të OSBE-së, në Prizren, z.Francis Carlier, me bashkëpunëtorët e tij, kurse takimi kishte karakter njohjeje.

Me këtë rast, z.Carlier, e ka uruar kryetarin Kilaj për zgjedhjen demokratike nga ana e qytetarëve, për kryetar komune edhe për një mandat katër vjeçar, përderisa ofroi mbështetjen e këtij misioni në punën, në këtë rast të komunës dhe e njoftoi kryetarin, se OSBE, misioni në Kosovë, do të vazhdoj me monitorimin e punës së komunave.

Kryetari Kilaj, e falënderoi drejtorin e qendrës regjionale të OSBE-së, për vizitën e tij, si dhe ofroi bashkëpunimin e komunës, me OSBE-në, në çdo aspekt, ndërsa për projektet që OSBE, dëshiron ti realizoj në Malishevë, Kilaj, i njoftoi ata, se nuk kanë nevojë të marrin



leje për ndonjë aktivitet, por gjithmonë do ta kenë edhe bashkëpunimin edhe pjesëmarrjen e komunës, dhe të tij personalisht në këto projekte.

Në këtë takim është diskutuar edhe për rrjedhat politike, me theks të veçantë në Asamblenë Komunale, dhe për opozitën. “Jam kryetar i të gjithëve dhe i përfaqësor të gjithë, ndërsa opozita do ta ketë përkrahjen e time dhe asnjë grup parlamentar nuk do të jetë i diskriminuar”, ju ka thënë kryetari Kilaj, zyrtarëve të lartë të OSBE-së.

Po ashtu në këtë takim, janë diskutuar edhe çështje tjera, siç është çështja gjinore, për të cilën kryetari Kilaj, i njoftoi zyrtarët e OSBE-së, se femra është e përfaqësuar në Asamble me 30 për qind.

Premtohet mbështetje për shoqatën e të verbërve

Malishevë, 4 shkurt

Shoqata e të verbërve në Malishevë, ka marrë sot premtimin e Kryetarit të Komunës, z. Isni Kilaj, për mbështetje të kësaj shoqate dhe anëtarëve të saj, për vijimin e një kursi, për mësimin e alfabetit të Brajlit, në mënyrë që edhe kjo kategori, të jetë pjesë aktive e shoqërisë.

Po ashtu sot, kryetari Kilaj, ju ka premtuar nxënësve të fshatit Janqisht, se nga java e ardhshme, do ta kenë të siguar transportin, për në shkollë, pasi fëmijët e këtij fshati, vijnë në mësimin në fshatin Shkozë, ndërsa numri i tyre është rreth 30 nxënës.

Këto premtime, kryetari Kilaj, ju ka bërë përfaqësuesve të shoqatës së personave të verbër dhe në rastin e dytë përfaqësuesve të fshatit Janqisht, në kuadër të takimeve të rregullta javore, me qytetar, që e mban çdo të enjte nga ora dhjetë, deri në dymbëdhjetë.

Në takimin e sotëm, të rregullt me qytetar, kryetari Kilaj, ka pritur dhjetëra qytetar, ku është njohur me hallet dhe nevojat e tyre, në fusha të ndryshme dhe me problemet me të cilat qytetarët ballafaqohen në jetën e përditshme.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Kërkohet harmonizimi i rregulloreve komunale me ligjet në fuqi

Malishevë, 8 shkurt

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, e cila mbahet çdo javë, kryetari i komunës së Malishevës, ka parashtruar disa kërkesa, për të cilat ka kërkuar realizimin e tyre.



Ndër të tjera z. Kilaj ka kërkuar nga drejtorët që ti harmonizojnë të gjitha rregulloret komunale me ligjet në fuqi të shtetit. Pastaj kë kërkuar, që të thirret një seance solemne, për shënimin e 17 Shkurtit, dy vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, mbledhje kjo, e cila do të mbahet në kuadër të aktiviteteve zyrtare të shënimit të kësaj date.

Po ashtu, në këtë mbledhje, kryetari Kilaj ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, sigurimin e

10 mijë kg miell, për nevoja të qytetarëve, të cilët e kanë mungesë ushqimin, pastaj bërjen gati të projektit për ndërtimin e aneksit të shkollës në Marali, si dhe të shikohet gjendja e urës së përkohshme në rrugën Mirushë- Gurbardh dhe të merren masat e sigurisë për të. Gjithashtu është kërkuar edhe vazhdimi i mbajtjes së takimeve të rregullta të Këshillit për Sigurinë në Bashkësi, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punët e përditshme.

Brenda javës konkursi edhe për mësimdhënës për Qendrën e Kompetencës

Malishevë, 15 shkurt

Brenda javës, do të shpallet konkursi për pranimin e mësimdhënësve, në shkollën e mesme profesionale, Qendra e Kompetencës në Malishevë. Kështu është bërë e ditur në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, përderisa ecuria e deritanishme për kompletimin stafit dhe mbarëvajtjes së punimeve është vlerësuar e kënaqshme, nga ana e Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj.



Në mbledhjen e sotme, kryetari Kilaj, ka konstatuar se drejtorët kanë përmbushur obligimet e marra nga java e kaluar, për hartimin e projektit për aneksin e

shkollës në Marali, pastaj për çështjen e sigurimit të urës në liqenin Mirusha, sigurimin e dhjetë mijë kilogramëve të miellit për nevojat e qytetarëve me gjendje të rëndë sociale, si dhe largimi i mbledhësve të hekurishteve, nga rrugët kryesore, ashtu siç është e paraparë me rregulloret mbi këtë çështje.

Në këtë takim është biseduar edhe për aktivitetet që do të mbahen me rastin e shënimit të Ditës së Pavarësisë, ku me 16 shkurt do të mbahet një mbledhje solemne, ndërsa një manifestimin qendror do të mbahet më 17 Shkurt, në palestrën sportive “Bekimi”, përderisa ecuria për organizimin e të gjitha aktiviteteve ka shkuar mirë dhe çdo gjë është gati për festimin e Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

U mbajt seancë solemne me rastin e dy vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Kilaj: “Jemi krenar për luftën që bëmë për shtetin tonë, Republikën e Kosovës”

Malishevë, 16 shkurt

Me rastin e shënimit të dy vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Komunës së Malishevës, mbajti seancë solemne, në të cilën morën pjesë, anëtarët e KK-së dhe drejtorët komunal, përfaqësues të institucioneve tjera në Malishevë, nga shoqëria civile, si dhe qytetarë të tjerë.

Fjalimin kryesor, e ka mbajtur Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, si dhe udhëheqësit e grupeve të këshilltarëve në KK të Malishevës, Enver Hoti në emër të këshilltarëve të PDK-së, Januz Kastrati në emër të LDK-së, Fatos Kryeziu nga AAK-ja, Hafir Rexha i AKR-së dhe Milazim Rudi nga LDD-ja, si dhe në emër të mysafirëve, mori fjalën ish Kryetari i Komunës, z.Jakup Kastrati, të cilët kanë uruar qytetarët me rastin e dy vjetorit të



shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Në vazhdim fjalimi i Kryetarit të Komunës:

I nderuar kryesues i Kuvendit, zonja dhe zotërinj kuvendarë të dashur mysafir, sot, po shënojmë dyvjetorin e bërjes së ëndrrave realitet të qindra gjeneratave, mijëra dëshmoreve, sakrificave të panumërta për liri të popullit shqiptar-për të ardhur deri te 17 Shkurti 2008 dhe kurorëzimin e kësaj lirie me shpalljen e shtetit të pavarur, Republikën e Kosovës.

Luftërat e shumta ndër shekuj, robëri shumëshekullore, pushtues të ndryshëm, ndarja e trojeve të shqiptarëve në shumë pjesë, ishin karakteristika që e përcollën fatin tonë që nga krijimi i shteteve të para iliro dardane e deri te krijimi i shtetit më të ri në botë, Republikën e Kosovës. Padrejtësisht na kishin ndarë edhe më 1912 pas rënies së Perandorisë Osmane. Atëbotë kërkonim të ishim pjesë e shtetit tonë Shqipërisë. Bëmë shumë luftëra por vetëm ndërruam pushtuesin i cili erdhi edhe më i egër. Ishin sllavet të cilët krijuan shtetet e tyre mbi tokat shqiptare. Më 1918 u krijua edhe ngrehina e përbashkët e tyre e cila do të merrte emrin Jugosllavi nga e cila do të pësonin shumë popuj por më së shumti shqiptarët. Edhe lufta e dytë botërore, është pse në mbajtëm anën e progresistëve nuk fituam të drejtat e plota. Tek më 1968 fituam të drejtën për gjuhë dhe flamur e që do pasohej me një autonomi gjysmake e cila as për nga shtrirja dhe as për nga përmbajtja nuk na e siguronte lirinë. Dhe lufta vazhdoi. Më 1988/89 kur kishte filluar rënia e socializmit në Evropë ne ndihmuam rrënimin e ngrehinës Jugosllavi sepse synim kishim lirinë kombëtare dhe bashkimin me Shqipërinë. Luftërat u përhapen gjithandej Republikave Jugosllave të cilat e arritën shkëputjen por jo shqiptaret dhe atë deri ne shfaqjen e vizionarit dhe legjendarit Adem Jashari i cili na tregoi rrugën që duhet ndjekur për të fituar lirinë e kërkuar. Qëndresa e Jasharajve mobilizoi një popull të tërë i cili do rrokte armët e lirisë dhe do përballej me një armik të egër dhe barbar dhe shumë të pabarabartë. Barbarët mbollën kudo vdekje, tmerr, vrasje mizore të fëmijëve burrave e grave pleq, dogji dhe shkrumboi si në mesjetë gjithë Kosovën, dëboi më tepër se gjysmën e popullit por nuk mundi të ndalte luftën e drejtë të bijve të Adem Jasharit të cilët vazhduan luftën deri në çlirimin definitiv të Kosovës. Gjatë kësaj lufte Kosova dha më tepër se 1500 dëshmorë të Kombit mijëra martire dhe mbi 3000 të zhdukur dhe një shkatërrim të paparë të vendit.



Malisheva dha një kontribut të jashtëzakonshëm gjatë historisë sonë në luftë për çlirim të vendit. Malisheva dhe i gjithë regjioni i saj janë një vend arkeologjik tejet i pasur me vendbanime ilire. Janë të njohura luftërat që nga viti 1914 me luftën e Banjës, lufta e Alush Smajlit në Llozicë, dënimet e

shqiptareve në procesin e Prizrenit, luftën e vëllezërve Berisha dhe më e rëndësishmja e gjithë historisë sonë është lufta e UÇK-së, e cila në Malishevë mbledhi mbi 2500 luftëtarë të lirisë të organizuar në dy Brigada. Ato i dhanë lirisë dhjetëra beteja të mëdha qindra aksione i dhanë nderë e lavdi popullit të Kosovës. Malisheva dha 70 dëshmorë në tri luftërat që zhvilluan shqiptarët, i dha 360 martir, 60 të zhdukur për lirinë që po e gëzojmë ne sot. Nga kjo mund të themi se 17 Shkurti nuk erdhi pse deshën të huajt por sepse ne bënë lufte shumëshekullore të mijëra brezave për të arrit deri te kjo liri që për ne nuk është liri të cilën e kemi ëndërruar dhe kërkuar por është liri e cila na siguron rrugën e drejt të bashkimit të kombit në Evropën e popujve të bashkuar. Sot Republika jonë po rritet e fuqizohet çdo ditë bashkë me fëmijët e dëshmorëve të cilët po rriten në liri.



Ne jemi krenar për luftën që bëmë, për shtetin tonë Republikën e Kosovës.

Lavdi te gjithë dëshmorëve të Kombit,

Rroftë Republika e Kosovës

Rroftë Republika e Shqipërisë

Rroftë ëndrra e Bashkimit Kombëtar!

Së shpejti do të formohet Komiteti për Biznese

Malishevë, 22 shkurt

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ka paralajmëruar mbledhjen e parë të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), për këtë vit dhe ka kërkuar nga drejtorët, që deri të mërkurën, të jenë të gatshme, rregulloret e reja, në mënyrë që ti prezantohen KPF-së, para daljes për miratim në Kuvendin e Komunës.

Po ashtu në këtë mbledhje, kryetari Kilaj, ka paralajmëruar një takim me përfaqësuesit e biznesit në Malishevë dhe mundësinë e formimit të komitetit të biznesit, si dhe të shikohet mundësia e një investimi konkret në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, ndërsa Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka kërkuar hartimin e një projekti, për mbjelljen e drunjve dekorativ në qytet.

Në mesin e shumë çështjeve të diskutuara në këtë mbledhje është kërkuar edhe fillimi i procesit të zgjedhjeve të kryesive të fshatrave, bazuar në ligjet dhe në statutin e komunës.

U diskutuan edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve në komunë.

Mbahet mbledhja e parë e KPF-së

Malishevë, 24 shkurt

Sot është mbajtur mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), për këtë vit, por edhe nga përbërja e re e Asamblesë Komunale, e dalë nga zgjedhjet e fundit komunale. Të pranishëm në takim ishin gjashtë anëtar, nga nëntë sa duhet ti ketë KPF, pasi që tre anëtar nga radhët e opozitës (LDK), nuk kanë marrë pjesë, ndërsa është udhëhequr nga kryesuesi i Asamblesë Komunale, z. Ragip Begaj.



Në këtë mbledhje janë shqyrtuar dhe janë rekomanduar për asamble, pesë rregullore, tri nga Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, si dhe dy rregullore nga Drejtoria e Arsimit.

Po ashtu Komiteti për Politikë e Financa, ka shqyrtuar edhe kërkesat e qytetarëve, të cilat i janë drejtuar këtij komiteti.

Formohet komiteti i biznesit në Malishevë

Malishevë, 24 shkurt

Me iniciativë të kryetarit të komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, dhe në prani të Den Vagner, zyrtar i lartë i Agjencionit Evropian për zhvillimin për rajonin e Prizrenit, është mbajtur një takim me komunitetin e biznesit të Malishevës dhe si rezultat është formuar edhe komiteti i biznesit në këtë komunë.

“Zhvillimi i komunitetit të biznesit është interes edhe i Malishevës dhe një organizim i tillë bënë të mundur që ju të bashkëpunoni për të fituar grande dhe projekte të cilat do të jenë në interesin e qytetarit të Malishevës po edhe në interesin e bizneseve të cilat ju i përfaqësoni”, ka thënë kryetari Kilaj dhe në të njëjtën kohë, ka premtuar se do të ndaj mjete për sigurimin e një



zyre pastaj për pagesën e një zyrtari, deri sa asociacioni të forcohet.

“Zëri i Malishevës në Agjencionin për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, do të jetë i fuqishëm dhe prioritet e saja do të merren parasysh, do të ofrojmë projekte të ndryshme pasi po dizajnojmë strategjinë rajonale për zhvillim ku është edhe Malisheva”, ka thënë Vagner duke treguar shembuj të përfitimit nga bizneset që ka ardhur si fryt i bashkëpunimit në të kaluarën.

Pas këtyre vlerësimeve, me propozimet e vet përfaqësuesve të biznesit, është formuar një këshill i përkohshëm i këtij komiteti, me përbërje prej gjashtë anëtarëve.

Daut Krasniqi, Agim Morina, Nijazi Kastrati, Bexhet Bytyçi, Elisaj Kelmendi dhe Haki Mazreku, janë anëtarët e komiteti të biznesit në Malishevë.